



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VIII

Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-037

Prishtinë, më 23 maj 2022, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 23 MAJ 2022

Në mbledhje morën pjesë: Glauk Konjufca, kryetar i Kuvendit; Saranda Bogujevci, Enver Hoxhaj, Kujtim Shala, Slavko Simiq dhe Bekim Arifi, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare në mbledhje morën pjesë: Armend Muja, Abelard Tahiri, Arben Gashi, Time Kadrijaj dhe Enis Kervan.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Drejtori i Drejtorisë për Çështje Plenare dhe Procedurale, Sali Rexhepi, si dhe stafi përgjegjës në mbështetje të Kryesisë së Kuvendit.

Mbledhjen e drejtoi Glauk Konjufca, kryetar i Kuvendit.

Me propozimin e kryetarit, Kryesia e plotësoi rendin e ditës me pikën: Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve të qëndrimit dhe akomodimit të delegacionit nga Parlamenti i Republikës së Turqisë, i cili do ta realizoj një vizitë zyrtare në Kosovë nga data 30 maj deri më 1 qershor 2022.

Pastaj, Kryesia i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mëparshme të Kryesisë së Kuvendit,
2. Pikat e papërfunduara nga seancat e mëparshme,
3. Përgatitjet për seancë të re plenare,
4. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave.

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mëparshme të Kryesisë së Kuvendit, të mbajtura më 29 prill, më 5 dhe më 16 maj 2022

Kryesia nuk i miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 29 prill, më 5 dhe më 16 maj 2022.

Nënkryetari i Kuvendit, z. Kujtim Shala, pati vërejtje në transkriptin e mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 5 maj 2022, ngase ishte transkriptuar diskutimi i tij për të cilin ai tha se ka deklaruar se do të flasë pa mikrofon.

Kryesia konstatoi se nuk duhet të transkriptonen diskutimet që kanë karakter konsultativ për të gjetur zgjidhje për një çështje të caktuar.

2. Pikat e papërfunduara nga seancat e mëparshme

Kryesia nuk vendosi për vazhdimin seancave plenare me pikat e papërfunduara. Kryetari deklaroi se për vazhdimin e seancave të mëparshme me pikat e papërfunduara do të vendoset në javën e ardhshme.

3. Përgatitjet për seancë të re plenare

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme dhe pas diskutimeve, vendosi që seanca plenare e radhës e Kuvendit të Republikës së Kosovës të mbahet të enjten, më 26 maj 2022, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

- 1. Deklarimet jashtë rendit të ditës,*
- 2. Pyetjet parlamentare,*
- 3. Miratimi i procesverbalit nga seanca plenare e mëparshme,*
- 4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-033 për provimin e jurisprudencës,*
- 5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-052 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës,*
- 6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-070 për pijet e forta alkoolike,*
- 7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit 08/L-010 për krijimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit hapësinor në Republikën e Kosovës,*
- 8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-027 për mbeturinat nga industrinë nxjerrëse të mineraleve,*
- 9. Zgjedhja e pesë (5) zëvendësve të Avokatit të Popullit,*
- 10. Zgjedhja e një (1) anëtari të Komisionit të Pavarur për Media.*

Kryetari i GP të PDK-së, Abelard Tahiri, propozoi që në rendin e ditës të seancës plenare më 26 maj 2022 të radhitet edhe pika: Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr.08/L-134 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-101 për fondet pensionale të Kosovës.

Në lidhje me propozimin e lartshënuar, diskutuan: përfaqësuesi i GP të LVV-së, Armend Muja; kryetari i GP të PDK-së, Abelard Tahiri, dhe kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve të lartshënuara, kryetari konstatoi se shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-134 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-101 për fondet pensionale të Kosovës do të procedohet për shqyrtim në seancë plenare, pasi të shqyrtohet në Komisionin Funkcional, ngase akoma është në kornizat e afatit kohor për shqyrtimin e tij.

4. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave

1. Propozimi për rishpalljen e konkursit për dy (2) anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nga komunitetet joshqiptare

Kryesia lidhur me propozimin e lartshënuar mori këtë:

V E N D I M

1. Të rishpallet konkursi publik për zgjedhjen e dy (2) anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nga komunitetet joshqiptare.
2. Ngarkohet Administrata e Kuvendit që, në bazë të dispozitave të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ta publikojë konkursin publik nga pika një (1) e këtij vendimi.

2. Propozimi për rishpalljen e konkursit për një (1) anëtar të Bordit për Ankesa të Mediave

Kryesia lidhur me propozimin e lartshënuar mori këtë:

V E N D I M

1. Të rishpallet konkursi publik për zgjedhjen e një (1) anëtari të Bordit për Ankesa të Mediave.
2. Ngarkohet Administrata e Kuvendit që, në bazë të dispozitave të Ligjit nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, ta publikojë konkursin publik nga pika një (1) e këtij vendimi.
3. *Propozimi për Formimin Komisionit ad hoc për përmirësimin dhe forcimin e procesit zgjedhor*

Kryetari i njoftoi të pranishmit se në takimin me kryetarët e grupeve parlamentare, të mbajtur më 13 prill 2022, është nënshkruar deklarata e përbashkët nga kryetarët e grupeve parlamentare në

lidhje me përmirësimin dhe forcimin e procesit zgjedhor, sipas së cilës janë pajtuar që të formohet Komisioni ad hoc për përmirësimin dhe forcimin e procesit zgjedhor.

Kryetari kërkoi nga Administrata e Kuvendit që para mbledhjes së ardhshme të Kryesisë së Kuvendit ta përgatisë propozimin për përbërjen e këtij komisioni.

4. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Gjermani

Kryesia lidhur me kërkesën e lartshënuar mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Arben Gashi dhe Armend Zemaj, u lejohej udhëtimi zyrtar në Berlin (Gjermani), prej datës 1 deri më 4 qershor 2022.
2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit, të akomodimit, të pjesëmarrjes dhe mëditjet për të lartshënuarit në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

5. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Bukuresht (Rumani)

Nënkryetarja e Kuvendit, Saranda Bogujevci, i njoftoi të pranishmit se deputeti Gazmend Gjyshinca e ka tërhequr kërkesën për lejimin e udhëtimit zyrtar në Rumani.

6. Kërkesa e znj. Mirlinda Morina, bashkëshorte e të ndjerit Bujar Morina, ish-nëpunës i Administratës së Kuvendit për mbështetje financiare

Kryesia lidhur me kërkesën e lartshënuar mori këtë:

V E N D I M

1. Znj. Mirlinda Morina, bashkëshorte e të ndjerit Bujar Morina, ish-nëpunës i Administratës së Kuvendit, mbështetet financiarisht në shumën prej 4,780.44 euro, për shpenzimet e një operacioni dhe hospitalimin, si dhe shpenzimet e varrimit të të ndjerit Bujar Morina.
2. Mjetet e parapara në pikën një (1) të këtij vendimi ndahen nga kategoria ekonomike: subvencione dhe transfere dhe transferohen në xhironlogarinë bankare të znj. Mirlinda Morina.

7. Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve të qëndrimit dhe akomodimit të Delegacionit nga Parlamenti i Republikës së Turqisë, i cili do ta realizojë një vizitë zyrtare në Kosovë nga data 30 maj deri më 1 qershor 2022

Kryesia lidhur me kërkesën e lartshënuar mori këtë:

V E N D I M

Mbulohen shpenzimet e akomodimit për delegacionin prej tre (3) anëtarëve të Parlamentit të Turqisë dhe ofrohet transporti nga Aeroporti i Prishtinës deri në Prishtinë dhe anasjelltas, në lidhje me vizitën zyrtare që do ta realizojnë në Kosovë, prej datës 30 maj deri më 1 qershor 2022.

Të ndryshme:

Kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca, kërkoi nga të pranishmit që të përshpejtohet puna për miratimin e Rregullores së re të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Nënkryetarja e Kuvendit, znj. Saranda Bogujevci, kërkoi nga Administrata e Kuvendit që ta përgatisë një propozim-vendim me të cilin rregullohet lejimi i udhëtimeve të delegacioneve të përhershme të Kuvendit në organizata ndërkombëtare.

Kryetari i GP të PDK-së, z. Abelard Tahiri, kërkoi që të fillohet me procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë në orën 12:17 minuta.

Glauk KONJUFCA

Kryetar i Kuvendit

Procesverbalin e hartoi:

Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale